

Pranuar / Dorezuar Priljezin / Prilato Received / Delivery	29-04 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	SKM/SHCK	2550/2022	114
Nr Prot Br Prot Prot No		Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.297/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1559/2019 të datës 21.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.222/2019 të datës 29.03.2019 e parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër 01/251 të datës 06.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Malishevës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.222/2019 e datës 29.03.2019, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Komuna e Malishevës, në bazë të autorizimit të datës 27.11.2018 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti të Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 03.12.2018 me numër 01/1709 ka shpallur konkursin për pozitën “Inspektor i Veterinës”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Në cilin konkurs ka qenë i hapur pesëmbëdhjetë ditë (15) nga data 03.12.2018 dhe është vazhduar deri më datën 25.12.2018.

Me datë 03.01.2019 me numër 01/02 Kryetari i Komunës së Malishevës merr Urdhëresën Administrative, me të cilën urdhërohet Zyra e Personelit që të anuloj të gjitha procedurat e mëtejme në lidhje me konkursin me numër 01/1709 të datës 03.12.2018 për plotësimin e vendit të punës “Inspektor i Veterinës”.

Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Malishevës, me datë 03.01.2019 me numër 01/03 ka bërë njoftimin për anulim të konkursit me numër 01/1709 të datës 03.11.2018 për vendin e punës “Inspektor i Veterinës”.

Ankuesi i pa kënaqur me njoftimin e datës 03.01.2019 për anulim të konkursit me datë 08.01.2019 parashtron ankesën me numër 01-16 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Malishevës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Malishevës, me datë 06.03.2019 merr vendimin me numër 01/251 me të cilin vendim

refuzohet ankesa e ankuesit dhe ka lënë në fuqi njoftimin me numër 01/03 të datës 03.01.2019 të Zyrës së Personelit të Komunës së Malishevës.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër 01/251 të datës 06.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Malishevës, me datë 29.03.2019 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 1633/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 20.05.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 21.03.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1559/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 20.05.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 29.03.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 28.03.2022 me numër të protokollit 1646/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.1559/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 01.04.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Malishevës. Komuna e Malishevës më datë 19.04.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 29.03.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 06.03.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Malishevës; Ankesa e ankuesit e datës 08.01.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Malishevës; Autorizimi i datës 27.11.2018 i lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti të Administrimit të Shërbimit Civil; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës për pozitën “Inspektor të Veterinës”; Konkursi i datës 03.12.2018; Vazhdimi i konkursit 25.12.2018; Njoftimi për anulim i datës 03.01.2019; Regjistri i aplikacioneve të pranuar (Form.MAP-SHCK-04); Urdhëresa Administrative e datës 03.01.2019 e Kryetarit të Komunës së Malishevës; Kërkesa për shpallje të konkursit e datës 09.01.2019 e Drejtorit të Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së Malishevës; Kërkesa për punësim e datës 24.12.2018 e kandidatit (Form.MAP-SHCK-03) me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e datës 24.12.2018 e kandidatit

(Form.MAP-SHCK-03) me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e datës 24.12.2018 e kandidatit (Form.MAP-SHCK-03) me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e datës 18.12.2018 e kandidatit (Form.MAP-SHCK-03) me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e datës 14.12.2018 e kandidatit (Form.MAP-SHCK-03) me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e datës 13.12.2018 e kandidatit (Form.MAP-SHCK-03) me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e datës 14.12.2018 e kandidatit (Form.MAP-SHCK-03) me dokumentacionin e bashkangjitur si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është **e pa bazuar sepse;**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili ka pretenduar se procedura e rekrutimit për vendin e punës “Inspektor i Veterinës” është zhvilluar në kundërshtim me ligjin e shërbimit civil dhe të rregullores për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, po ashtu ka pretenduar se i ka plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit si dhe kërkon që të obligohet Kryetari i Komunës që të vazhdojë me procedurën e rekrutimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore në bazë të shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, ka shqyrtuar gjithë procesin e rekrutimit dhe ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën “Inspektor i Veterinës” e shpallur nga Komuna e Malishevës, duhet të nderprehët në këtë fazë sepse nuk është në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se sipas konkursit të datës 03.12.2018 kriteret kualifikuese për vendin e punës “Inspektor i Veterinës” në Komunën e Malishevës, kanë qenë:


- *Diploma e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinës dega e veterinarisë;*
- *Përvojë e punës: 3 vite përvojë pune profesionale, etj.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor ka vlerësuar ligjshmërinë e gjithë procesit të procedurës së rekrutimit të kësaj pozite, respektivisht pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar, se nga tetë (8) kandidatët që kanë aplikuar në konkursin e datës 03.12.2018, për pozitën “Inspektor i Veterinës” në Komunën e Malishevës, vetëm një kandidat i plotëson kushtet për tu përzgjedhur në listën e shkurtë ndërsa kandidatët dhe nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuara sipas konkursit të shpallur. gjegjësisht kriterin e *përgatitjes profesionale dhe atë të përvojës së punës profesionale pas diplomimit.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se krijimi i listës së ngushtë duhet të bëhet në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Rregullores 02/2010 për Procedura të Rekrutimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: **“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathhtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës”.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën “Inspektor i Veterinës” në Komunën e Malishevës, në këtë fazë nuk mund të zhvillohet me vetëm një kandidat. pasi që nuk është përmbushur parimi i konkurrencës, ashtu siç përcaktohet me nenin 29 paragrafin 1 të Rregullores 02/2010 për Procedura të Rekrutimit në Shërbimin Civil ku theksohet se **“KPSHC duhet të përgatisë një listë të shkurtër prej së paku tre kandidatëve. Nëse paneli nuk mund të identifikoj së paku tre kandidatë adekuat për përfshirje në listën e shkurtë, pozita duhet të rishpallet”**, gjegjësisht Kolegji konstaton se për te vazhduar procedurën e rekrutimit në këtë fazë duhet të jenë tre kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të konkursit, ndërsa në rastin konkret kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të konkursit për pozitën “Inspektor i Veterinës” në Komunën e Malishevës, i ka plotësuar vetëm një kandidatë, andaj Kolegji konstaton se në çdo rrethane konkursi do të anulohet, dhe si tille pretendimi ankimor i ankuesit për të vazhduar me procedurën e rekrutimit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të dëshmitëve të ofruara ka konstatuar se me datë 03.01.2019 Zyra e Personelit ka publikuar Njoftimin me numër 01/03 me të cilin ka njoftuar se me Urdhëresën Administrative me numër 01/02 të datës 03.01.2019 të Kryetarit të Komunës së Malishevës, është anuluar konkursi për pozitën “Inspektor i Veterinës” në Komunën e Malishevës, mirëpo edhe pse Kryetari i Komunës së Malishevës, në Urdhëresën Administrative nuk ka dhënë ndonjë arsytim për



anulimin e konkursit, Kolegji konstaton se atëherë sipas rrethanave dhe fakteve të lartcekura në këtë vendim konkursi do të anulohet.

Bazuar në këto rrethana. Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.297/2022

Valentina Kaçandoli Bektashi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

